



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike

**Projektvendim "PËR KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË
VETËQEVERISJES VENDORE, NUMRIT THELBËSOR DHE KËRKESESË SË
MJAFTUESHME TË PERSONAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE, PËR T'U
ARSIMUAR NË GJUHËN E PAKICËS KOMBËTARE"**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Postuar më: 06.03.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVEVDIM

Nr. _____, datë _____.____.2019

PËR

**KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE,
NUMRIT THELBËSOR DHE KËRKESESË SË MJAFTUESHME TË PERSONAVE TË
PAKICAVE KOMBËTARE, PËR T'U ARSIMUAR NË GJUHËN E PAKICËS
KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13 të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat që i përkasin një pakice kombëtare, kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare, në institucione arsimore të caktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Në institucionet arsimore ekzistuese, ku gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, nxënësit e një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurikulave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, numri thelbësor dhe kërkesa e mjaftueshme me qëllim sigurimin e së drejtës për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare, përcaktohen në bazë të kritereve të mëposhtme:
 - a. numri i personave që i përkasin pakicës kombëtare, i cili duhet të jetë jo më pak se 20 për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, si nëndarje e bashkisë;
 - b. periudha e regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas periudhave të regjistrimit të popullsisë, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga Regjistrat Themeltarë të

- c. kërkesa formale, paraqitur nga prindër apo kujdestarë ligjorë të fëmijëve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë bashkisë/njesisë administrative, ku shprehet vullneti në mënyrë formale dhe bazuar në të drejtën e vetë identifikimit, të mjaftueshme për formimin e klasës.

4. Numri i nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare që kanë të drejtën të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, duhet të jetë jo më pak se 15 nxënës për klasë në bazë të kërkesës formale nga prindërit apo kujdestarët ligjorë sipas përcaktimit në shkronjën c të pikës 3 të këtij vendimi.

5. Administrimi i informacionit për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 3 bëhet nga prefekti i qarkut. Pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve, prefekti përcakton njësinë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare do t'u sigurohet e drejta të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare.

6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë marrë konfirmimin sipas pikës 5 të këtij vendimi kanë të drejtën e nismës për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në përputhje me parashikimet në ligjore për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Brendshme, prefekti i qarkut dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Propozimet dhe sugjerimet tuaja me qëllim përmirësimit e projektvendimit janë të mirëpritura në adresat zyrtare të MASR:

Erzen.Tola@arsimi.gov.al

Altea.Tahiraj@arsimi.gov.al

Dokumenta:

- [Relacion per projektvendimin](#)

Diskutimet
